



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 22 Datë 05.09.2017

**“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI
ELEKTRIKE SUBJEKTIT “2AF ALBANIA GROUP” SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pikës 2,të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”, për paisjen me autorizim (miratim në parim) të subjektit “**2AF ALBANIA GROUP**” sh.p.k., me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponentës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “**2AF ALBANIA GROUP**” shpk, me administrator Z.AQIF KONESHA, për përdorim të burimit ujor **Përroi i Sharrës** dhe **Përroi i Duriqve**, degë e Lumit Zalli i Bulqizës, për prodhim energjie elektrike, në fshatin Vajkal, Njësia Administrative Bulqizë, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti **HEC DHOKSI** do të ketë këto të dhëna:

Vepra e marrjes nr.1(përroi i Sharrës): $X_1 - 44\ 37\ 124$; $Y_1 - 45\ 94\ 532$; $Z_1 - +1500$ m

Vepra e marrjes nr.2(përroi i Duriqve): $X_2 - 44\ 37\ 760$; $Y_2 - 45\ 94\ 840$; $Z_2 - +1500$ m

Koordinatat e godinës së centrali: $X - 44\ 36\ 620$; $Y - 45\ 97\ 000$; $Z - +750$ m;

Koordinatat e pikës së shkarkimit : $X - 44\ 36\ 620$; $Y - 45\ 97\ 000$; $Z - +750$ m;

Prurja mesatare e burimit ujor: $Q_{1mes} = 0.072$ m³/sek; $Q_{2mes} = 0.064$ m³/sek;

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: Q_1 llog = 0.085 m³/sek; Q_2 llog = 0.075 m³/sek

Prurja ekologjike: $Q_{1ekol} = 0.015$ m³/sek; $Q_{2ekol} = 0.012$ m³/sek

Prurja që shkarkohet: $Q = 0.16$ m³/sek.

2- Autorizimi(miratimi në parim) i përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Sekretari

Martin PLLUMBI



Kryetar

Paulin RADOVANI